

**Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë**  
**Ministria e Punëve të Brendshme**  
**Drejtoria I**  
**Tiranë 9 prill 1990**  
**Sekret**

Lënda: Për disa veprime të kryera nga një grup personash në qytetin e Kavajës

Shokut: Ramiz Alia dhe Adil Çarçani

Më datën 25.03.1990 në orët e para të mëngjesit, në disa njësi tregtare të qytetit të Kavajës u gjendën fletushka armiqësore të heliografuara në të cilat shkruhej: “Thirrje ... u bëjmë thirrje të gjithë atyre që janë bindur se propaganda komuniste është fund e krye mashtrim... Të bashkohemi me zërin e përbashkët të urrejtjes në ndeshjen e 25 marsit “Partizani” – “Besa” dhe në minutën e 80 të lojës, të ngrihemi me gishtat lart duke thirrur fort e pa pushim “Liri, Demokraci” ... t’i lajmë me gjakun tonë shkallët e stadiumit ...”.

Të ndodhur përpara kësaj situatë, si dhe nga të dhënat e grumbulluara disa ditë më parë nga ana jonë u morën një sërë masash operative dhe ushtarake për të zbuluar e neutralizuar këtë veprimtari. Për rrjedhojë, gjatë zhvillimit të ndeshjes nuk pati shqetësime, por nga një punonjës policie u fiksua një i ri nga Kavaja që thërriste “Ngrihuni çuna, gati për revolucion” dhe disa të tjerë të pidentifikuar që thërrisnin “Demokraci – Demokraci”. Personi i identifikuar u ndalua, pranoi që kish bërë thirrje të tilla e implikoi edhe disa persona të tjerë.

Pas mbarimit të ndeshjes, një grup mbi 200 persona të moshës së re nuk u largua nga stadiumi, filluan të shanin e goditnin me gurë punonjësit e policisë. Për të fiksuar dhe identifikuar se cilët ishin ata, u përdor kamera televizive.

Nga analiza që i bëmë kësaj ngjarjeje, me qëllim që të zbulohet dora e armikut, të parandalohet ndonjë veprim më i mprehtë armiqësor u konkludua të thirren, sqarohen e paralajmërohen 23 persona që ishin shkaktarë të prishjes së rendit në stadium.

Në datën 26.03.1990, rreth orës 18.00, pa krijuar asnjë shqetësim, u thirrën në rajonin e policisë Kavajë, dy nga personat e diferencuar. Rreth orës 19.00 të kësaj date u pa një turmë e madhe personash që vinin në drejtim të policisë, kryesisht të moshës së re, duke thirrur: “Lironi shokët tanë; liri, demokraci; Rroftë Ramiz Alia; Poshtë dinastia; Poshtë diktatura; Poshtë pushteti popullor” dhe më pas filluan të godasin me gurë duke thyer disa xhama të godinës. Më pas, turma, me rreth 200 – 300 persona, ku më aktivët duhet të ishin 3-40 vetë, u largua për në qendrën e qytetit duke thirrur e hedhur parruga armiqësore dhe çdo thirrje nga turma shoqërohej me “urra”. Ndërkohë ndizen dritat e bulevardit dhe turma u shpërnda.

Menjëherë pas kësaj ngjarjeje të rëndë, u bë identifikimi i 32 personave që ishin në krye të turmës dhe 12 prej tyre me miratim të sekretarit të parë, u thirrën në bashkëbisedim. Të gjithë pranuan që kishin marrë pjesë në rrëmujën e krijuar në hedhjen e parullave armiqësore dhe në

goditjen me gurë të policisë, por asnjëri prej tyre nuk pranoi që këto veprime t'i kishte bërë për motive armiqësore. Nga personat e thirrur, 2 që ishin më aktivët u arrestuan dhe me ta vazhdoi hetuesia e përpunimi në dhomat e izolimit gjithashtu kemi intensifikuar masat operative për të zbuluar, neutralizuar e goditur organizatorët e kësaj veprimtarie.

Duke analizuar ngjarjen e ndodhur në qytetin e Kavajës në 25 de 26 mars 1990, disa të dhëna e sinjalizime që kishim marrë më parë për të, si dhe disa veprime të mprehta armiqësore, si: shkruarjen e parullave armiqësore në datën 29.03.1990 në shkollën e mesme "Medar Shtylla", hedhjen e disa fletushkave në qytet më 9.02.1990 apo fyerjen publikisht në dy raste të udhëheqjes kryesore të Partisë më datën 20.03.1990, si dhe kundërshtimin në mënyrë demonstrative të zgjedhjes së drejtoreshës së re të qilimave me thirrjet "ajo është serbe, është si Sllobodani" të një grupi prej 40 – 50 grash, arrijmë në përfundimin se e gjithë kjo punë armiqësore është e studiuar dhe organizuar me kujdes.

Disa nga shkaqet që çuan në këtë ngjarje të rëndë e me pasoja janë:

Së pari, evidentohet një punë e pamjaftueshme e rajonit të Punëve të Brendshme Kavajë, për të njohur gjendjen e situatën operative konkrete, për të mësuar e parandaluara në këtë veprimtari armiqësore të organizuar. Nga ne në Kavajë, nuk u vlerësuan në shkallën e duhur ngjarjet e ndodhura në Shkodër, Tiranë e Durrës, e për rrjedhojë ka patur ulje vigjilence.

Ngjarja evidentoi edhe lidhje të pakta të punonjëse tanë me masat punonjëse. Është fakt se opinioni i masës për disa punonjës sidomos të policisë, nuk është i mirë. Kjo ndoshta edhe e nxitur, propaganduar e shfrytëzuar nga armiku i klasës.

Së dyti, krahas mangësive në punën tonë, ndaj të cilëve po këmbëngulim t'i riparojmë sa më shpejt për të dominuar e paraprirë situatës operative, duhet thënë se armiku në Kavajë ka shfrytëzuar disa mungesa e probleme të mprehta shoqërore që kanë ekzistuar e ekzistojnë e konkretisht:

Në qytetin e Kavajës vazhdimisht ka qenë problem zënia në punë e forcave të lira. Në vitin 1989 të tillë kanë qenë mbi 2000 persona, kryesisht të moshave të reja. Edhe aktualisht zënia me punë mbetet problem i hapur.

Vitet e fundit tregu nuk është furnizuar ritmikisht, ka patur mungesa në mish, vezë, qumësht e nënprodukte të tij. Për tremujorin e parë të vitit vetëm nga në tollon mish e një djathë (1 kg) u është dhënë qytetarëve. Këtë muaj u shtua edhe nga 1kg mish e 1 kg djathë.

Në vitin 1989 dhe në këtë tremujor, në ndërmarrjet e qytetit ka patur ndërprerje të energjisë elektrike, disa mungesa në lëndën e parë, këto kanë krijuar probleme në pagën e punëtorëve. Në qytetin e Kavajës me një popullsi mbi 28.000 banorë, me përjashtim të një pallati kulture e një kinemaje, nuk ka objekte të tjera çlodhëse e argëtuese për rininë, pa folur këtu për ritmin e ulët në ndërtimin e banesave për qytetarët. Duhet thënë se në Kavajë, me kërkesa të shumta për strehim e zgjerim, dorëzohen jo më shumë se 15 – 20 apartamente në vit.

Së treti, në vlerësimin e ngjarjes spikat një dukuri mjaft negative, ka një indiferentizëm e një liberalizëm të theksuar që do të thoshim është tradicional. Është fakt se ngjarjen që ndodhi e panë dhe e dëgjuan shumë qytetarë, por deri më sot me përjashtim të atyre që janë thirrur nga ana jonë, asnjë nuk ka denoncuar.

Së katërti, një dukuri tjetër që tërheq vëmendjen është zhvillimi në mënyrë masive i ndjenjave dhe riteve fetare, jo vetëm te të moshuarit, por edhe në të rinjtë. Thuajse te të gjithë personat që kemi thirrur e pyetur, dalin qartë konceptet fetare e sidomos ai për të mos folur për të tjerët, sepse sipas tyre “qitapi dhe ungjilli” nuk e lejojnë.

Megjithëse ngjarja që ndodhi ishte shumë e rëndë e me qëllim të caktuara politike, parullat armiqësore që u hodhën, u dëgjuan nga një masë njerëzish, nga kuadrot drejtuese të Partisë, pushtetit dhe ekonomisë, ajo vlerësohet si një veprim i thjeshtë dhe akt rrugaçerie i bërë nga disa vagabondë.

Megjithë punën e bërë dhe masat intensive që janë marrë, të dhënat e ditëve të fundit në rrugë operative dhe hetimore flasin se ngjarje të tilla do të përsëriten edhe në të ardhmen, madje në përpjesëtime e intensitet më të madh. Pa tërhequr vëmendjen nga Kavaja, të dhënat tregojnë se kjo veprimtari duhet të jetë e lidhur dhe organizuar me veprimtarinë armiqësore të rretheve të tjera, si në Tiranë, Shkodër e gjetkë, nuk përjashtohet mundësia që pas kësaj veprimtarie të fshihet edhe dora e zbulimeve të huaja.

Në bashkëpunim me organet e hetimit dhe organet e tjera, po e ndjekim problemin me përparësi për të zbuluar, parandaluar dhe goditur fort e në kohë çdo veprim të mundshëm, me synim zbulimin dhe goditjen e organizatorëve të këtyre veprimeve.

Ministri i Punëve të Brendshme  
Simon Stefani